
Rekomandim CM/Rec(2018)4

**i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi
pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën publike në vend**

*(Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 21 mars 2018
në mbledhjen e 1311-të të zëvendës ministrave)*

Komiteti i Ministrave, sipas kushteve të nenit 1 5.b të Statutit të Këshillit të Europës,

Duke pasur parasysh që synimi i Këshillit të Europës është arritja e unitetit më të madh ndërmjet anëtarëve të tij për qëllim të ruajtjes dhe realizimit të idealeve dhe parimeve që janë trashëgimi i tyre e përbashkët dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe social të tyre;

Duke pasur parasysh që pjesëmarrja e qytetarëve qëndron në themel të idesë së demokracisë dhe që qytetarët të cilët janë të përkushtuar ndaj vlerave demokratike, të ndërgjegjshëm për detyrat e tyre qytetare dhe aktivë në jetën publike, janë fuqia e çdo sistemi demokratik;

Duke riafirmuar besimin e tij se demokracia përfaqësuese është pjesë e trashëgimisë së përbashkët të shteteve anëtare dhe është baza e pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën publike në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal;

Duke kujtuar praktikatat e demokracisë së drejtpërdrejtë në disa Shtete anëtare;

Duke pasur parasysh që demokracia pjesëmarrëse, e cila respekton dhe njeh rolin e të gjithë aktorëve, mund kontribuojë dhe të plotësojë demokracinë përfaqësuese dhe të drejtpërdrejtë, duke i bërë institucionet demokratike më shumë të përgjegjshme, për të kontribuar kështu në shoqëri përfshirëse dhe të qëndrueshme;

I bindur që demokracia lokale është një nga gurët e themelit të demokracisë në vendet evropiane dhe që përforsimi i saj është faktor stabiliteti;

Duke vënë në dukje se demokracia lokale në ditët e sotme funksionon në një kontekst sfidues i cili po zhvillohet vazhdimisht si rezultat jo vetëm i ndryshimeve strukturore dhe funksionale në organizimin e pushtetit vendor, por edhe i ndryshimeve politike, ekonomike, kulturore dhe zhvillimeve sociale në Europë;

I vetëdijshëm që pritshmëritë e publikut vazhdojnë të evoluojnë, që politika lokale vazhdon të ndryshojë formë ndërsa qytetarët kërkojnë dhe praktikojnë mënyra të reja për t'u angazhuar dhe për t'u shprehur, dhe që kjo kërkon, edhe më shumë se sa në të kaluarën, më shumë metoda për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë dhe fleksibël;

Duke marrë parasysh që vazhdon të ekzistojë nevoja që institucionet publike lokale të ri-angazhohen dhe t'i përgjigjen qytetarëve në mënyra të reja për të ruajtur legjitimitetin e proceseve vendimmarrëse, veçanërisht meqë është duke u ulur, shumë shpesh sot, niveli i besimit të qytetarëve në institucionet e zgjedhura të tyre;

Duke pranuar se ekziston një larmi e gjerë e masave që janë lehtësisht të adaptueshme me rrethanat lokale për të promovuar pjesëmarrjen e qytetarëve;

Duke pasur parasysh se e drejta e qytetarëve për të thënë fjalën e tyre në vendimet kryesore që sjellin angazhime afatgjata ose zgjedhje të cilat janë të vështira për t'u kthyer dhe të cilat kanë të bëjë me ta, është një nga parimet demokratike të përbashkëta për të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Europës;

Duke pasur parasysh që kjo e drejtë mund të ushtrohet më drejtpërdrejt në nivel lokal dhe që, në përputhje me rrethanat, duhet të merren hapa për të përfshirë qytetarët më drejtpërdrejt në drejtimin e punëve në vend, ndërkohë që duhet të ruhet efektiviteti dhe efikasiteti e këtij drejtimi;

Duke pasur parasysh që dialogu ndërmjet qytetarëve dhe autoriteteve lokale dhe përfaqësuesve të zgjedhur është thelbësor për demokracinë vendore, pasi forcon legjitimitetin e institucioneve demokratike lokale dhe efektivitetin e veprimit të tyre;

Duke pasur parasysh që, në përputhje me parimin e subsidiaritetit, autoritetet vendore kanë dhe duhet të marrin, një rol udhëheqës në promovimin e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe që angazhimi i tyre është i rëndësishëm për suksesin e çdo politike vendore për pjesëmarrje demokratike;

Duke pasur parasysh nevojën për të përditësuar Rekomandimin Rec(2001)19 e Komitetit të Ministrat për Shtetet anëtare mbi pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën publike në vend, dhe duke pasur parasysh që ndryshimet që kanë ndodhur që pas miratimit të tij justifikojnë zëvendësimin e tij nga rekomandimi në fjalë;

Duke pasur parasysh:

- Protokollin Shtesë të Kartës së Vetëqeverisjes Vendore mbi të drejtën e pjesëmarrjes në punët e një autoriteti vendor (CETS Nr.207);
- Rekomandimin CM/Rec(2009)2 e Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi vlerësimin, auditimin dhe monitorimin e pjesëmarrjes dhe politikave të pjesëmarrjes në nivel lokal dhe rajonal, dhe instrumentin CLEAR bashkëlidhur atij;
- 12 Parimet e Mirë-Qeverisjes Demokratike; dhe
- Udhëzimet për pjesëmarrjen civile në vendimmarrjen politike (CM(2017)83-final);

Rekomandon që qeveritë e shteteve anëtare të ndërmarrin detyrat e përcaktuara në paragrafët 1 deri në 5 më poshtë, ose t'i besojnë këto detyra autoriteteve kompetente publike, duke pasur parasysh rregullimet e tyre përkatëse kushtetuese ose legjislative.

1. të hartojnë një politikë, duke përfshirë autoritetet vendore dhe - sipas rastit- rajonale me qëllim promovimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën publike në vend, bazuar në:

- parimet e Kartës Europiane të Vetëqeverisjes Vendore (ETS Nr. 122);
 - Protokollin Shtesë të Kartës Europiane të Vetëqeverisjes Vendore për të drejtën e pjesëmarrjes në punët e autoritetit vendor (CETS Nr.207);
 - Udhëzimet për pjesëmarrje civile në vendimmarrje politike (CM(2017)83-final); dhe
 - parimet e përcaktuara në Seksionin A të shtojcës të këtij rekomandimi;
2. të miratojnë masa brenda kompetencës së tyre, duke pasur parasysh politikën e sipërpërmendur dhe Seksionin B të shtojcës së këtij rekomandimi, në veçanti me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor për pjesëmarrjen dhe sigurimin që legjislacioni dhe rregulloret kombëtare të bëjnë të mundur që autoritetet lokale dhe rajonale të përdorin një gamë të gjerë të instrumenteve të pjesëmarrjes;
3. të ftojnë, në një mënyrë e përshtatshme, autoritetet lokale dhe rajonale:
- që të pajtohen me parimet e përfshira në Seksionin A të shtojcës së këtij rekomandimi dhe të ndërmarrin zbatimin efektiv të politikave të nxitjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën publike në vend;
 - të përmirësojnë rregulloret lokale dhe rajonale në lidhje me pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën publike në vend së bashku me marrëveshjet praktike për një pjesëmarrje të tillë, dhe të marrin çdo masë tjetër brenda kompetencës së tyre për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve, duke pasur parasysh masat e renditura në seksionin B të shtojcës së këtij rekomandimi;
4. të rishikojnë rregullisht politikat e miratuara në lidhje me pjesëmarrjen e qytetarëve për të siguruar që ato të jenë sa më efektive dhe të përditësuar;
5. të sigurojnë që ky rekomandim të përkthehet në gjuhë(t) zyrtare të vendeve përkatëse dhe, në një mënyrë që ata e konsiderojnë të përshtatshme, të publikohet dhe të silllet në vëmendje të autoriteteve lokale dhe rajonale;

Vendos që ky rekomandim zëvendëson Rekomandimin Rec(2001)19 e Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën publike në vend.

Shtojca e Rekomandimit CM/Rec (2018)4

Për qëllimet e këtij rekomandimi:

- “jetë publike në vend” do të thotë të gjitha çështjet, shërbimet dhe vendimet dhe në veçanti punët e drejtimit dhe administrimit që kanë të bëjnë ose që lidhen me një komunitet lokal;
- “ qytetar ” do të thotë çdo person (përfshirë, sipas rastit, rezidentë të huaj¹) që i përket një komuniteti lokal. Përkatësia në një komunitet lokal përfshin ekzistencën e një lidhjeje të qëndrueshme ndërmjet individit dhe komunitetit.

Përkufizimet e termave të tjera të përdorura në këtë rekomandim janë dhënë në relacionin shpjegues të tij (CM(2018)13-final).

A. Parimet bazë të politikave të pjesëmarrjes demokratike në vend

Shtetet anëtare duhet:

1. të përmbushin parimet për dhënien e informacionit të përcaktuara në Konventën e Këshillit të Europës mbi Njohjen me Dokumentet Zyrtare (CETS nr. 205) në lidhje me çështje të ndryshme me interes për komunitetin lokal në mënyrë që qytetarët e tyre të kenë të drejtën e fjalës në vendime të cilat ndikojnë mbi komunitetet e tyre ose mbi ata individualisht dhe të mundësojnë transparencë në vendimmarrjen e autoriteteve vendore, duke rritur kështu llogaridhënien e vendimmarrësve;
2. të kërkojnë mënyra të reja për të rritur ndërgjegjësimin qytetar dhe për të promovuar kulturën e pjesëmarrjes demokratike mes komuniteteve dhe autoriteteve lokale;
3. të zhvillojnë vetëdijen për përkatësinë në një komunitet dhe të inkurajojnë qytetarët që të pranojnë përgjegjësinë e tyre për të kontribuar në jetën e komuniteteve të tyre;
4. t'i japin rëndësi të madhe komunikimit ndërmjet autoriteteve publike dhe qytetarëve dhe të inkurajojnë autoritetet lokale për të vendosur theksin në pjesëmarrjen e qytetarëve dhe t'i kushtojnë vëmendje të kujdesshme kërkesave dhe pritshmërive të tyre, me qëllim që të japin përgjigjen e duhur ndaj nevojave që ata shprehin;
5. të miratojnë një qasje gjithëpërfshirëse për pjesëmarrjen e qytetarëve, duke pasur parasysh edhe proceset e demokracisë përfaqësuese edhe format e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në vendimmarrje dhe menaxhimin e çështjeve lokale;
6. të shmangin zgjidhjet tepër të ngurta dhe të lejojnë eksperimentimin, duke i dhënë përparësi fuqizimit të qytetarëve; për rrjedhojë, shtetet anëtare duhet të sigurojnë një gamë të gjerë instrumentesh pjesëmarrjeje dhe mundësi të kombinimit të tyre dhe përshtatjes së mënyrave të përdorimit të tyre, në varësi të rrethanave;
7. të fillojnë me një vlerësim të thelluar të situatës në lidhje me pjesëmarrjen lokale, të vendosin standarde të përshtatshme dhe të prezantojnë një sistem monitorimi për të ndjekur çdo ndryshim, me qëllim identifikimin e shkaqeve të tendencave pozitive ose negative në pjesëmarrjen e qytetarëve dhe matjen e ndikimit të mekanizmave të miratuara;
8. të mundësojnë shkëmbimin e informacion ndërmjet dhe brenda vendeve mbi praktikatat më të mira për pjesëmarrjen e qytetarëve, të mbështetin të mësuarit e autoriteteve lokale për efektivitetin e metodave të ndryshme të pjesëmarrjes dhe të sigurojnë që publiku të jetë plotësisht i informuar për të gjithë gamën e mundësive në dispozicion, duke pasur parasysh Rekomandimin CM/Rec(2009)2 e Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi vlerësimin, auditimin dhe monitorimin e pjesëmarrjes dhe politikave të pjesëmarrjes në nivel lokal dhe rajonal dhe instrumentin CLEAR bashkëlidhur tij;
9. t'i kushtojnë vëmendje të veçantë qytetarëve që e kanë më të vështirë për t'u përfshirë në mënyrë aktive ose që, *de facto* , mbeten dytësorë në jetën publike në vend;
10. të promovojnë pjesëmarrjen e ekuilibruar të grave dhe burrave në jetën politike në vend dhe jetën publike në vend;

¹ Në përputhje me Konventën për Pjesëmarrjen e të Huajve në jetën publike në nivel lokal (ETS Nr. 144 – cf. neni 2), termi “rezidentë të huaj” janë persona që nuk janë shtetas të Shtetit dhe që janë rezidentë të ligjshëm në territorin e tij.

11. të njohin potencialin që përfaqësojnë fëmijët dhe të rinjtë për zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve lokale dhe të theksojnë rolin që ata mund të luajnë;
12. të njohin dhe të përmirësojnë rolin e luajtur nga shoqatat dhe grupet e qytetarët si partnerët kyç në zhvillimin dhe ruajtjen e një kulture të pjesëmarrjes dhe si forcë shtytëse në zbatimin praktik të pjesëmarrjes demokratike;
13. të dallojnë se si shoqëritë kulturalisht të ndryshme dhe përfshirëse mund të lehtësojnë pjesëmarrjen e të gjithëve në jetën publike të komuniteteve të tyre;
14. të inkurajojnë dhe përdorin përpjekjet e përbashkëta të autoriteteve në të gjitha nivelet e qeverisjes, ku çdo autoritet është përgjegjës për ndërmarrjen e veprimeve të duhura brenda kompetencës së tij, sipas parimit të subsidiaritetit.

B. Hapat dhe masat për të inkurajuar dhe përforcuar pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën publike në vend

I. Hapat dhe masat e përgjithshme

Shtetet anëtare duhet:

1. të konstatojnë nëse, në një shoqëri komplekse dhe të globalizuar, rëndësia e veprimit lokal dhe vendimmarrjes i është bërë e qartë publikut duke identifikuar rolet kryesore për autoritetet lokale në një mjedis të ndryshueshëm;
2. të vendosin theksin e duhur te këto role dhe të konstatojnë, nëse e nevojshme, nëse ekuilibri i kompetencave të ushtruara në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor siguron që autoritetet vendore dhe përfaqësuesit e zgjedhur të kenë kompetenca dhe kapacitete të mjaftueshme për veprim lokal për të ofruar stimulim dhe motivim në nevojshëm për përfshirjen e qytetarëve. Në këtë kontekst, Shtetet anëtare duhet të përdorin çdo mundësi për decentralizimin funksional, duke e shtrirë përgjegjësinë e autoriteteve lokale;
3. t'u japin autoriteteve vendore mundësinë të prezantojnë, në nivel fqinjësie, struktura pjesëmarrëse që u ofrojnë qytetarëve mundësitë për të ndikuar në mjediset e tyre më të afërta;
4. të përmirësojnë edukimin qytetar dhe të përfshijnë në kurrikulat e shkollës dhe programet mësimore të trajnimit objektivin e promovimit të ndërgjegjësimit për përgjegjësitë që janë detyrë e çdo individ në një shoqëri demokratike, në veçanti brenda komuniteteve të tyre lokale, qoftë si përfaqësues të zgjedhur, administratorë lokalë, nëpunës publikë ose qytetarë të thjeshtë, në përputhje me Kartën e Këshillit të Europës për Arsimin për Qytetari Demokratike dhe Edukimin për të Drejtat e Njeriut (Rekomandim CM/Rec(2010)7 i Komitetit të Ministrave);
5. të inkurajojnë përfaqësuesit e zgjedhur vendorë dhe autoritetet vendore me çdo mjet të përshtatshëm, duke përfshirë hartimin dhe publikimin e kodeve të sjelljes, që të sillen në një mënyrë që është në përputhje me standardet e sjelljes etike dhe frymëzon besimin e qytetarëve, duke pasur parasysh:
 - Rezolutën 401 (2016) të Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Europës mbi “Parandalimin e korrupsionit dhe promovimin e etikës publike në nivel lokal dhe rajonal”;
 - Kodin European të sjelljes për integritetin politik të përfaqësuesve të zgjedhur vendorë dhe rajonalë; dhe
 - Doracakun 2006 mbi Etikën Publike në Nivel Lokal;
6. të prezantojnë transparencë më të madhe në mënyrën se si funksionojnë institucionet dhe autoritetet vendore dhe në veçanti:
 - i. të sigurojnë natyrën publike të proceseve vendimmarrëse (për shembull duke publikuar agjendat e mbledhjeve të këshillit vendor dhe nivelit ekzekutiv vendor; hapjen e mbledhjeve të këshillit vendor dhe komitetit të tij për publikun; zhvillimin e sesioneve me pyetje dhe përgjigje ose publikimin e procesverbaleve të takimit dhe vendimeve);
 - ii. të sigurojnë dhe të lehtësojnë njohjen e çdo qytetari me informacion në lidhje me çështjet lokale (për shembull duke krijuar zyra informacioni, qendra dokumentacioni dhe baza të dhënash publike; duke përdorur teknologjitë e komunikimit dhe informacionit; duke thjeshtuar procedurat administrative dhe duke reduktuar kostot e sigurimit të kopjeve të dokumenteve), në përputhje me legjislacionin për privatësinë dhe sigurinë;
 - iii. të sigurojnë informacion adekuat për organet administrative dhe strukturën e tyre organizative dhe të informojnë qytetarët të cilët janë drejtpërdrejt të prekur nga ndonjë proces në vazhdim të progresit të këtyre proceseve;

7. të zbatojnë një politikë të plotë komunikimi në mënyrë që t'u ofrohet qytetarëve mundësia për të kuptuar më mirë çështjet kryesore me interes për komunitetin dhe pasojat e vendimeve të mëdha politike të cilat kërkohen të merren nga organet, dhe të informojnë qytetarët rreth mundësive për pjesëmarrje në jetën publike lokale dhe format që mund të marrë ajo.

II. Hapat dhe masat lidhur me pjesëmarrjen në zgjedhjet vendore dhe sistemin e demokracisë përfaqësuese

Shtetet anëtare duhet:

1. të rishikojnë funksionimin e sistemeve zgjedhore lokale për të konstatuar nëse ka ndonjë të metë thelbësore ose marrëveshje votimi që mund të dekurajojë pjesë të veçanta të popullsisë për të mos votuar dhe të shqyrtojnë mundësinë e korrigjimit të këtyre të metave ose marrëveshjeve në përputhje me Kodin e Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të miratuar nga Komisioni Europian për Demokracinë përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) (CDL-AD(2002)023rev-E);

2. të përpiqen të promovojnë pjesëmarrjen në zgjedhje, në përputhje me legjislacionin kombëtar për të drejtat e votimit. Kur është e nevojshme, shtetet anëtare duhet të zhvillojnë fushata informimi për të shpjeguar se si bëhet votimi dhe për të inkurajuar njerëzit që të regjistrohen për të votuar dhe për të përdorur votën e tyre. Fushatat e informimit që synojnë pjesë të veçanta të popullsisë mund të jenë edhe një mundësi e përshtatshme;

3. të verifikojnë regjistrimin e votuesve dhe pjesëmarrjen në zgjedhje për të identifikuar çdo ndryshim në modelet e përgjithshme ose ndonjë problem që përfshin kategori ose grupe të veçanta qytetarësh që kanë të drejtë të votojnë, por që tregojnë pak interes për të votuar;

4. të marrin parasysh masat për ta bërë votën më të përshtatshme, duke pasur parasysh kompleksitetin dhe kërkesat e mënyrave moderne të jetesës, për shembull me anë të:

- i. rishikimit të mënyrës së funksionimit të qendrave të votimit (numri, aksesueshmëria, orari i hapjes, etj.);
- ii. prezantimit të opsioneve të reja të votimit, që korrespondojnë më nga afër me aspiratat e qytetarëve të çdo Shteti anëtar (votimi i hershëm, votimi me postë, votimi në postë, votimi elektronik,² etj.);
- iii. prezantimit të formave specifike të ndihmës (për shembull për personat me aftësi të kufizuara ose analfabetë) ose të rregullimeve të tjera të veçanta të votimit për kategori të veçanta të votuesve (votim me prokurë, votimi në shtëpi, votimi në spital, votimi në baraka, votimi në burgje, etj.);

5. sipas nevojës, me qëllim për të kuptuar më mirë ndikimin e ndonjë mase të parashikuar, të kryejnë (ose të lejojnë) skema pilot për testimin e rregullimeve të reja të votimit;

6. të shqyrtojnë bazën mbi të cilën kandidatët që kanë të drejtë të kandidojnë për zyrën zgjedhore vendore të mund ta bëjnë këtë dhe të vlerësojnë, për shembull:

- i. nëse votuesit duhet të përfshihen në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve, për shembull duke prezantuar mundësinë e paraqitjes së listave të pavarura apo kandidaturave individuale, ose duke prezantuar votimin preferencial;
- ii. nëse votuesve duhet t'u lejohej ndikim më i madh në zgjedhjen ose emërimin e (drejtuesve të) drejtuesve ekzekutivë lokalë ose kryetarëve të bashkive;

7. të shqyrtojnë çështjet që kanë të bëjnë me pluralitetin e detyrave publike të të zgjedhurve, me qëllim miratimin e masave të krijuara për të parandaluar mbajtjen njëkohësisht të pozicionit nëse kjo do të pengonte kryerjen e duhur të detyrave përkatëse ose do të çonte në konflikt interes;

8. të shqyrtojnë kushtet që rregullojnë ushtrimin e detyrës të caktuar me zgjedhje për të përcaktuar nëse aspekte të veçanta të statusit të përfaqësuesve të zgjedhur vendorë ose rregullimet praktike për ushtrimin e detyrës mund të pengojnë përfshirjen në politikë. Sipas rastit, Shtetet anëtare duhet marrin parasysh masat e krijuara për të hequr këto pengesat dhe, në veçanti, për të mundësuar që përfaqësuesit e zgjedhur t'i kushtojnë kohën e duhur detyrave të tyre dhe t'i lehtësojnë ata nga disa kufizime ekonomike.

² Duke pasur parasysh Rekomandimin CM/Rec(2017)5 të Komitetit të Ministrave për Shtetet anëtare mbi standardet për votimin elektronik.

III. Hapat dhe masat për të inkurajuar pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrjen lokale dhe në menaxhimin e punëve në vend

Shtetet anëtare duhet:

1. të promovojnë dialogun ndërmjet qytetarëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur vendorë dhe të ndërgjegjësojnë autoritetet lokale për teknikat e ndryshme të komunikimit me publikun, dhe gamën e gjerë të mënyrave se si qytetarët mund luajnë një rol të drejtpërdrejtë në vendimmarrje. Ky ndërgjegjësim mund të zhvillohet duke publikuar udhëzime (për shembull në formën e një kartë për pjesëmarrjen e qytetarëve në nivel lokal), duke zhvilluar konferenca dhe seminare ose duke krijuar arkiva digjitale dhe ndërfaqeve për të bërë të mundur postimin dhe për t'u njohur me shembujt e praktikës së mirë;
2. të zhvillojnë, përmes sondazheve dhe diskutimeve, të kuptuarit e pikave të forta dhe të dobëta të instrumenteve të ndryshme për pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje dhe të inkurajojnë novacion dhe eksperimentim në përpjekjet e autoriteteve lokale për të komunikuar me qytetarët dhe për t'i përfshirë ata më nga afër në proceset e vendimmarrjes;
3. të përdorin plotësisht, sidomos:
 - i. teknologjitë e reja të informacionit dhe komunikimit dhe të ndërmarrin hapa për të siguruar që autoritetet lokale dhe organet e tjera publike të përdorin (përveç metodave tradicionale dhe ende të vlefshme si p.sh njoftime formale publike ose fletëpalosje zyrtare) gamën e plotë të mjeteve të komunikimit në dispozicion, duke konsultuar, për shembull, Rekomandimin CM/Rec(2009)1 e Komitetit të Ministrave për Shtetet anëtare mbi demokracinë elektronike (e-demokracia) dhe Rekomandimin Rec(2004)15 e Komitetit të Ministrat për shtetet anëtare mbi qeverisjen elektronike ("e-qeverisja");
 - ii. më shumë forma konsultative të vendimmarrjes, pra, duke përfshirë shkëmbimin e informacionit dhe opinionëve (për shembull mbledhjet publike, kuvendet e qytetarëve dhe jurive ose lloje të ndryshme të forumeve qytetare, grupeve, paneleve dhe komisioneve publike funksioni i të cilëve është të këshillojnë ose të bëjnë propozime, ose tryeza të rrumbullakëta, sondazhet e opinionit dhe anketimet e përdoruesit);
4. të prezantojnë ose, kur është e nevojshme, të përmirësojnë legjislacionin ose rregulloret të cilat mundësojnë:
 - i. petitionet, mocionet, propozimet dhe ankesat e qytetarëve të paraqitura në këshillin vendor ose administratën vendore;
 - ii. nismat popullore që u bëjnë thirrje organeve të zgjedhura që të merren me çështje specifike në mënyrë që t'u ofrojnë qytetarëve një përgjigje ose të nisin një procedurë referendumi;
 - iii. referendume konsultative ose vendimmarrëse për çështje me interes lokal, të thirrura nga autoritetet vendore me nismën e tyre ose me kërkesë të komunitetit lokal, duke marrë parasysh Kodin e Praktikës së Mirë për Referendumet të miratuar nga Komisioni European për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) (CDL-AD(2007)008rev);
 - iv. mekanizmat për emërimin e qytetarëve në organet vendimmarrëse, duke përfshirë organet përfaqësuese;
 - v. mekanizmat për përfshirjen e qytetarëve në menaxhim (komitetet e përdoruesve, bordet e partneritetit, menaxhimi i drejtpërdrejtë i shërbimeve nga qytetarët, buxhetimin me pjesëmarrje, etj.);
5. t'u japin qytetarëve më shumë ndikim mbi planifikimin lokal dhe, në një mënyrë të përgjithshme, mbi vendimmarrjen strategjike dhe afatgjatë; më konkretisht:
 - i. t'u japin qytetarëve mundësinë për të marrë pjesë në faza të ndryshme të procesit të vendimmarrjes në lidhje me këto vendime. Këto fazat mund të jenë: përgatitja, adoptimi, zbatimi, vlerësimi dhe riformulimi i politikave lokale;
 - ii. të ilustrojnë çdo fazë të procesit me anë të një materiali të qartë dhe të kuptueshëm që është lehtësisht i arritshëm nga publiku, duke përdorur, nëse e mundur, përveç metodave tradicionale (hartat, modelet e shkallës, material audiovizual) mjete të tjera në dispozicion përmes teknologjive të reja;
6. të zhvillojnë mekanizma sistematike të reagimit për të përfshirë qytetarët në vlerësimin dhe përmirësimin e menaxhimit të çështjeve lokale dhe ofrimit të shërbimit, të tilla si anketat e përdoruesit, panelet e përdoruesit, treguesit e performancës, ose në zgjedhjen ndërmjet ofruesve të ndryshëm të shërbimeve, me qëllim rritjen e cilësisë së vendimeve dhe shërbimeve dhe rritjen e llogaridhënies;

7. të sigurojnë që pjesëmarrja e qytetarëve të ketë një ndikim të vërtetë në proceset e vendimmarrjes, që qytetarët të mirë- informohen për ndikimin e pjesëmarrjes së tyre dhe që ata të shohin rezultate të prekshme. Megjithatë, autoritetet vendore duhet të jenë të sqarta me publikun rreth kufizimeve të formave të pjesëmarrjes që ofrohen dhe të shmangin krijimin e pritshmërive të ekzagjeruara për mundësinë e akomodimit të interesave të ndryshme të përfshira, veçanërisht kur merren vendime ndërmjet interesave konfliktuale ose për ndarjen e burimeve;

8. të inkurajojnë dhe të njohin siç duhet frymën e vullnetarizmit që ekziston në shumë komunitete lokale, për shembull përmes skemave të grantit apo formave të tjera të mbështetjes dhe inkurajimit për organizata jofitimprurëse, vullnetare dhe komunitare, grupe veprimi të qytetarëve, etj., ose nëpërmjet zhvillimit të kontratave ose marrëveshjeve ndërmjet këtyre organizatave dhe autoriteteve lokale lidhur me të drejtat, rolet dhe pritshmëritë përkatëse të këtyre palëve në marrëdhëniet e tyre me njëri-tjetrin;

9. të zhvillojnë struktura pjesëmarrëse në nivel fqinjësie që lejojnë qytetarët të ndikojnë te vendimet lidhur me investimet publike, ndarjen e zonave ose ofrimin e shërbimit, ose të marrin përsipër përgjegjësi për menaxhimin e hapësirave lokale, ambienteve etj., për shembull nëpërmjet këshillave dhe forumeve në nivel fqinjësie, buxhetimit me pjesëmarrje ose grupeve vullnetare.

IV. Hapat dhe masat specifike për inkurajimin e kategorive të qytetarëve të cilët për arsye të ndryshme e kanë më të vështirë të marrin pjesë

Shtetet anëtare duhet:

1. të mbledhin rregullisht informacion mbi pjesëmarrjen e kategorive të ndryshme të qytetarëve dhe të konstatojnë nëse disa grupe janë të nënpërfaqësuar në organet e zgjedhura dhe/ose luajnë pak ose aspak rol në format e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë ose elektorale, duke pasur parasysh përbërjen gjithnjë e më të larmishme të shoqërive europiane dhe rëndësinë e shoqërive përfshirëse;
2. të vendosin objektiva për arritjen e niveleve të caktuara të përfaqësimit dhe/ose pjesëmarrjes së grupeve të qytetarëve të interesuar dhe të hartojnë paketa me masa specifike për të rritur mundësitë për pjesëmarrjen e tyre, për shembull:
 - i. duke prezantuar, për grupe qytetarësh të interesuar, një politike komunikimi dhe informimi aktiv që përfshin, sipas rastit, fushata specifike mediatike për t'i inkurajuar ata që të marrin pjesë (mund t'i kushtohet vëmendje adoptimit të një gjuhe të caktuar, media dhe stili të fushatës të përshtatur me nevojat e secilit grup);
 - ii. duke prezantuar forma të veçanta institucionale të pjesëmarrjes, të krijuara, aty ku është e mundur, në konsultim me grupin ose grupet e qytetarëve përfshirja e të cilëve inkurajohet;
 - iii. duke emëruar zyrtarë të veçantë përgjegjës për trajtimin e çështjeve me interes për ato grupe që kanë vështirësi më të mëdha për të marrë pjesë, duke i përcjellë kërkesat e tyre për ndryshim në organet përkatëse vendimmarrëse dhe duke ju raportuar atyre mbi progresin e bërë dhe përgjigjen (pozitive ose negative) e dhënë për këto kërkesa;
3. në lidhje me gratë në veçanti:
 - i. të theksojnë rëndësinë e një pjesëmarrjeje të ekuilibruar të grave dhe burrave në organet vendimmarrëse dhe të shqyrtojnë çdo rregullim që mund të lehtësojë përputhjen e përfshirjes aktive politike me jetën familjare dhe punën;
 - ii. të konsiderojnë, nëse është ligjërish e mundur, prezantimin e një sistemi të detyrueshëm ose të rekomanduar të kuotave për numrin minimal të kandidatëve të të njëjtit seks që mund të shfaqen në një listë zgjedhore dhe/ose të kuotave për vendet e rezervuara për gratë në këshillat vendore, organet ekzekutive lokale dhe komisionet e ndryshme dhe bordet e krijuara nga organet vendore, duke marrë parasysh Rekomandimin Rec(2003)3 e Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi pjesëmarrjen e ekuilibruar të grave dhe burrave në vendimmarrjen politike dhe publike;
4. në lidhje me fëmijët dhe të rinjtë sidomos:
 - i. të zhvillojnë shkollën si një arenë të përbashkët të rëndësishme për pjesëmarrjen e të rinjve dhe procesin demokratik të të mësuarit;
 - ii. të promovojnë nismat e llojit “këshilli i fëmijëve” dhe “këshilli i të rinjve” në nivel bashkiak si mjete të dobishme të edukimit për qytetarinë lokale, përveç mundësive për dialog me anëtarët më të rinj të shoqërisë;
 - iii. të inkurajojnë shoqatat rinore dhe të mbështetin, në veçanti, zhvillimin e formave fleksibël dhe strukturave për përfshirjen e komunitetit, si qendrat rinore, duke shfrytëzuar plotësisht aftësinë e të rinjve për të ideuar vetë projekte dhe për t'i zbatuar ato;

- iv. të konsiderojnë uljen e moshës për të votuar ose për të kandiduar në zgjedhjet vendore dhe për të marrë pjesë në referendume lokale, konsultime dhe nisma popullore;
 - v. të konsiderojnë lloje të tjera të ndryshme të iniciativave të sugjeruara nga Rekomandimi Rec(2004)13 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi pjesëmarrjen e të rinjve në jetën lokale dhe rajonale, Rekomandimi CM/Rec(2012)2 e Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve nën moshën 18 vjeç, dhe Rekomandimi 1864 (2009) i Asamblesë Parlamentare për “Nxitjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimet që i prekin ata”;
5. në lidhje me personat më të moshuar në veçanti:
- i. të krijojnë dhe promovojnë mundësi për më të moshuarit që të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës publike lokale dhe t'i inkurajojnë ata pavarësisht nga mosha e tyre;
 - ii. të zhvillojnë dhe promovojnë forma dhe struktura fleksibël për përfshirjen e më të moshuarve siç janë bordet e këshillit, duke marrë parasysh Rekomandimin CM/Rec(2014)2 e Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi promovimin e të drejtave të njeriut të personave më të moshuar;
6. në lidhje me personat me aftësi të kufizuara:
- i. të krijojnë dhe promovojnë mundësi për personat me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës publike lokale, dhe të marrin të gjitha masat e nevojshme për t'i lejuar dhe inkurajuar në këtë drejtim;
 - ii. të zhvillojnë dhe promovojnë forma dhe struktura të përshtatshme duke hequr pengesat dhe duke ofruar ndihmën e duhur sipas nevojës, për të përfshirë personat me aftësi të kufizuara, si p.sh. borde këshillimi, duke marrë parasysh Rekomandimin CM/Rec(2011)14 e Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në jetën politike dhe publike;
7. në lidhje me rezidentët e huaj ³ në veçanti, të inkurajojnë pjesëmarrjen e tyre aktive në jetën e vendasve komunitetit në a jodiskriminuese bazë, duke zbatuar dispozitat e Konventës 1992 mbi Pjesëmarrjen e Të huajve në Jetën Publike në nivel lokal (ETS Nr.144) ose, të paktën, duke u frymëzuar nga mekanizmat e përmendura në këtë konventë edhe nëse nuk është ratifikuar nga Shteti Anëtar.

³ Në përputhje me Konventën për Pjesëmarrjen e të Huajve në Jetën Publike në Nivel Lokal (ETS Nr. 144 - shih nenin 2), termi “rezidentë të huaj” janë persona që nuk janë shtetas të Shtetit dhe që janë rezidentë të ligjshëm në territorin e tij.